



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Pro & Co Group" Sh.P.K. të datës 10.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës Abedin Dino - Kolovicë, faza e parë" me nr. të prokurimit 616-23-3587-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 66 23 083 521, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Pro & Co Group" Sh.P.K. e datës 10.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës Abedin Dino - Kolovicë, faza e parë" me nr. të prokurimit 616-23-3587-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 66 23 083 521.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Pro & Co Group" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Pro & Co Group" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 10.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës Abedin Dino - Kolovicë, faza e parë" me nr. të prokurimit 616-23-3587-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 66 23 083 521. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merit (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): *“Me datën 07.06.2023, keni publikuar, njoftimin mbi vendimin e Autoriteti Kontraktues, me arsyetimin se çmimi i ofertës tejkalon vlerën e parashikuar, rrjedhimisht potencohet se “është kërkuar konfirmim nga njësia e kërkesës dhe drejtorisë për financa se nuk ka mjete shtese për ti shtuar për këtë aktivitet te prokurimit”. OE “PRO & CO GROUP” shpk, ne kuptim te dispozitave te nenit 108/A, te LPP-se, e kundërshton propozimin për anulim te aktiviteti te prokurimit me arsyetimin e tille, meçe janë konsumuar shkelje ligjore, përkatësisht te parimeve kryesore te ligjit për Prokurim Publik dhe te kodit etik te Prokurimit Publik. Pretendimet ankimore 1 OE “PRO & CO GROUP” shpk, ka prezantuar me oferte te përgjegjshme, për këtë proces te prokurimit, një gjë e tille është konfirmuar edhe nga anëtarët e komisionit vlerësues te ofertave sipas raportit te vlerësimit. Ndërsa, propozimi për anulim i aktivitetit te prokurimit me arsyetim se nuk ka mjete buxhetore shtese nuk është provuar me konfirmim nga njësia kërkuese apo edhe nga drejtoria e financave”.*

Pretendimi i dytë (II): *“Arsyetimi i propozimit për anulimit te aktivitetit te prokurimit , me arsyetimin se është konsultuar njësia kërkuese nuk gjen mbështetje ligjore pasi qe njësia kërkuese nuk është organ kompetent dhe nuk ka kurrë far funksioni ligjore për te përcaktuar dhe për te siguruar mjetet buxhetore. Neni 8, i rregullores nr 001/22, përcakton rolin e njësisë kërkuese, ku detyrat e tyre janë përgatitja formale e nevojave dhe përcjellja për aprovim te te njëjtës kërkesë tek zyrtari kryesor administrativ. Ndërsa neni 9 dhe 11, te rregullores nr 001/2022, përkatësisht neni 9, i LPP-se, përcaktojnë qe ZKF dhe ZKA, janë përgjegjës për sigurimin e mjeteve financiare për inicim te aktivitetit te prokurimit. Vendimi për anulim te aktivitetit te prokurimit bie ndesh me raportin e vlerësimit te ofertave, ku neve si komani jemi kualifikuar si te përgjegjshëm. Arsyetimi se nuk ka mjete buxhetore bie ndesh edhe me gjendjen faktike dhe si i tille shkel parimet e prokurimit publik, për faktin se ju si AK – Komuna Prishtine keni te publikuara ne ueb faqe kontrata te tani te lidhura, ne realizim e sipër qe kane te bëjnë pikërisht me ndërtim rrugësh te cilat nuk janë fare te planifikuara dhe përshkruara ne plan vjetor te prokurimit për vitin 2023. - Ndërtimi i rrugës Skënderbeu - Punë shtesë 616-23-133/1-525 - Ndërtimi i rrugës Dëshmorët e Ponoshecit dhe Sylejman Vuçiterna 616-23- 009-521”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 9, 18, 27 dhe 62 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”) si dhe neni 8, 9 dhe 11 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 19.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me të dy pretendimet e parashtruesit: fillimisht duhet cekur se LPP përmes nenit 62 par. 1 nënpar. 2 ka përcaktuar se “Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës nëse të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit”. Kjo dispozitë e LPP është në përputhje edhe me nenet 1 dhe 7 të LPP lidhur me menaxhimin efikas, efektiv dhe mbi të gjitha ekonomik të buxhetit të AK.

Bazuar në procesverbalin e hapjes së ofertave, raportin e vlerësimit si dhe njoftimit mbi vendimin është gjetur se në këtë aktivitet të prokurimit është dorëzuar vetëm një ofertë në vlerën 548,398.06 Euro. Në anën tjetër bazuar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit ka qenë vetëm 300,000.00 Euro. Me fjalë të tjera oferta e tenderuesit të vetëm (në këtë rast të parashtruesit) ka tejkalluar gati dy herë vlerën e parashikuar respektivisht ka tejkalluar për 82.8% vlerën e paracaktuar për këtë aktivitet të prokurimit. Pra nuk bëhet fjalë për tejkallim simbolik të vlerës së aktivitetit por bëhet fjalë për 248,398.06 Euro që përbëjnë 82.8% të vlerës së parashikuar nga autoriteti kontraktues.

Sidoqoftë, për autoritetin kontraktues ky aktivitet i prokurimit është mjaft i rëndësishëm prandaj me datë 5 qershor 2023 është kërkuar nga Drejtoria e Financave në Komunën e Prishtinës (autoriteti kontraktues) si dhe nga vet njësia kërkuese (Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave) që të shqyrtojnë mundësinë për të financuar shumën e tejkalluar të buxhetit të parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë të dy këto drejtori kompetente për menaxhimin e buxhetit në AK-Komunën e Prishtinës janë përgjegjgur në kërkesën e zyrtarit përgjegjës të prokurimit duke theksuar se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës nuk ka mjete në dispozicion për të mbuluar diferencën e vlerës për të cilën është tejkalluar shuma e planifikuar e buxhetit për këtë aktivitet të prokurimit.

Në këtë mënyrë është arritur deri te konstatimi se janë plotësuar të gjitha kushtet për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit duke u bazuar në nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin 2 të LPP lidhur me nenin 1 dhe nenin 7 të LPP, sikurse është cituar më sipër në këtë vendim. Pikërisht mbi këtë bazë ligjore dhe për shkak të kësaj gjendje faktike dhe juridike, është mbështetur edhe njoftimi mbi vendimin e AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit që është goditur me këtë kërkesë për rishqyrtim të parashtruesit. Prandaj është gjetur se të dy pretendimet parashtruesit janë të pabazuara në tërësi.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 19.06.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.